



**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
“STACIONI I AUTOBUSËVE” SH.A. – MITROVICË**

BORDI I DREJTORËVE

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me Statutin dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes, si dhe në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve nr. të protokollit 154/26, të datës 15.09.2026, Bordi i Drejtorëve i NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. – Mitrovicë shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për përzgjedhjen dhe emërimin e Kryeshefit Ekzekutiv

Pozita:	Kryeshef/e Ekzekutiv/e
Numri i pozitave:	1 (një)
Vendi i punës:	Mitrovicë
Mandati:	3 (tre) vite
Orari i punës:	Orarë i plotë

1. Përshkrimi i pozitës

Kryeshefi Ekzekutiv është përgjegjës për udhëheqjen, organizimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të veprimtarisë së Ndërmarrjes, zbatimin e vendimeve dhe politikave të Bordit të Drejtorëve, menaxhimin efikas të burimeve njerëzore, financiare dhe materiale, si dhe sigurimin e funksionimit të ligjshëm, profesional, transparent dhe efikas të Ndërmarrjes.

Kryeshefi Ekzekutiv i raporton drejtpërdrejt Bordit të Drejtorëve.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Kryeshefi Ekzekutiv:

- Udhëheqë dhe menaxhon veprimtarinë e përgjithshme dhe operacionet e përditshme të Ndërmarrjes;
- Zbaton vendimet, politikat dhe objektivat e përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve;
- Përgatitë dhe i propozon Bordit planet e biznesit, planet financiare, buxhetin, planet e investimeve dhe të zhvillimit të Ndërmarrjes;
- Mbikëqyrë menaxhimin financiar dhe administrativ dhe siguron përdorimin efikas dhe të përgjegjshëm të burimeve të Ndërmarrjes;

- Menaxhon dhe mbikëqyrë stafin dhe siguron zbatimin e legjislacionit, Statutit dhe akteve të brendshme të Ndërmarrjes;
- Raporton rregullisht para Bordit të Drejtorëve për veprimtarinë dhe performancën financiare, administrative dhe operative të Ndërmarrjes;
- Kryen detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes.

3. Kualifikimet dhe kriteret profesionale

Kandidati duhet:

- Të ketë diplomë universitare në **ekonomi, juridik ose shkencë shoqërore**
- Të ketë së paku **pesë (5) vite përvojë pune në nivel të lartë menagjerial**, në fushën e administrimit të biznesit, financave, menaxhimit, industrisë ose në një fushë tjetër të ndërlidhur me veprimtarinë e Ndërmarrjes;
- Të ketë aftësi të dëshmuara organizative, menagjeriale dhe udhëheqëse;
- Të ketë aftësi të mira të komunikimit me shkrim dhe me gojë;
- Të ketë aftësi për planifikim strategjik, vendimmarrje dhe menaxhim të burimeve njerëzore dhe financiare;
- Të ketë njohuri të legjislacionit dhe të parimeve të funksionimit dhe qeverisjes së ndërmarrjeve publike;
- Të ketë njohuri të nevojshme të punës me kompjuter;
- Të jetë person me integritet të lartë profesional dhe moral.

Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi.

4. Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Formularin e aplikimit;
- CV-në;
- Letrën e motivimit;
- Kopjen e diplomës universitare;
- Dëshmi për përvojën e punës dhe përvojën menagjeriale;
- Kopjen e dokumentit të identifikimit;
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më i vjetër se gjashtë muaj).

5. Procedura e përzgjedhjes

Përzgjedhja do të zhvillohet përmes një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese, të bazuar në meritë, në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe aktet e zbatueshme të Ndërmarrjes.

Pas verifikimit të dokumentacionit, kandidatët që plotësojnë kushtet e konkursit do t'u nënshtrohen fazave përkatëse të vlerësimit. Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen për intervistë.

6. Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur **15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit.**

Aplikacionet me dokumentacionin e kërkuar dorëzohen në:

NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. – Mitrovicë

Adresa: Rr. “Mbretresha Teutë”, Mitrovicë

E-mail: npstacioniautobusavem@hotmail.com

Afati i fundit për aplikim: 01.10.2026, ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

7. Mundësi të barabarta

NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. – Mitrovicë ofron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e konkursit, pa diskriminim dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

BORDI I DREJTORËVE

NPL “STACIONI I AUTOBUSËVE” SH.A. – MITROVICË

Ilir Parduzy, kryesues i bordit

